



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 89/2012**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 30.04.2012, mori këtë:

### **VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj.

### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 29.04.2012, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se me datë 29.04.2012 në shkollën “Besim Rexhepi” në Komogllavë 2510D/03, një person me emrin Floridana Limani në ora 11:20 ka tentuar të votojë, edhe pse nuk e kishte mbushur moshën 18 vjeç, duke kaluar të gjitha procedurat paraprake deri te kutia e votimit. Sipas parashtruesit të ankesës kjo vepër është në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP). Parashtruesi i ankesës potencon se ajo është shënuar si votuese me kusht.

Parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP-i, që të ndërmerren masat sanksionuese për të gjithë ata që kanë lejuar të kryej procedurat paraprake të votimit.

**Neni 118 paragrafi 1 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), përcakton se:**

*PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.*

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

## **Ankesa është e pabazuar**

Nga shkresat e lëndës PZAP-i konstatoi se ankesa është e pabazuar, ngase nuk i përmban elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, sepse parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë apo dëshmi që do ti mbështeste apo do ti argumentonte pretendimet ankimore që janë theksuar në ankesë. andaj në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë**

A nr. 89/2012 më datën 30.04.2012.

**Kryesuesi i Panelit  
Ymer Hoxha**

